



**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

**Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koço Gliozheni" Tiranë**

**Nr. 46/4 Prot**

**Tiranë, më 24.01.2024**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

“Blerje materiale mjekimi për SUOGJ “Koco Gliozheni” që mbulojnë me shërbimin shëndetësorë spitalor, për një periudhë 12 mujore”, objekti: Blerje material mjekimi e ndarë në 2 lote: Loti 1 “Materiale mjekimi MM1”, për një periudhë 12 mujore”, Loti 2 “Materiale mjekimi MM2, për një periudhë 12 mujore” – Marrëveshje kuadër me afat 12 mujor.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Materiale mjekimi te konsumueshme**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**FONDI LIMIT:** Bazuar në shkresën me Nr. 46 Prot, datë 09.01.2024 “Kërkesë Prokurim”, shkresës me Nr. 4126 Prot, date 14.11.2023 “Delegim procedure per materiaialet e mejkimit MM1 dhe MM2” nga MSHMS. Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: 37,473,930 (tridhjetë e shtatë milion e katërqind e shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH.

- 1. FONDI LIMIT:** Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: 37,473,930 (tridhjetë e shtatë milion e katërqind e shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH.
- 2. Loti 1 :** ” Blerje materiale mjekimi te pergjithshme per nevoja te S.U.O.GJ “Koço Gliozheni”  
Fondi limit/ Vlera e pritshme e kontratave është 19,206,400 (nentembedhjetë milion e dyqind e gjashtë mijë e katërqind ) lekë pa TVSH  
Shumatorja e cmimeve për njësi per Lot 1 është 107,449.70 (njeqind e shtate mije e katerqind e katerdhjete e nente pike shtatedhjete).
- 3. Loti 2 :** “ Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja te S.U.O.GJ “Koço Gliozheni”

Fondi limit/ Vlera e pritshme e kontratave është 18,267,530 (tetembedhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH

Shumatorja e cmimeve për njësi është për Lot 2 është 45051.78 (dyzet e pese mije e pesedhjetë e nje pike shtatedhjetë e tete) leke

#### **4. Kohëzgjatja e përafërt e kontratës/marrëveshjes kuadër : 12 muaj**

##### **1.1 Përshkrimi i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe/ose Lotit (eve), nëse përdoren:**

Blerje material mjekimi e ndarë në 2 lote Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: **37,473,930** (tridhjetë e shtatë milion e katërqind e shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH

Loti 1 : ” Blerje materiale mjekimi te pergjithshme per nevoja te S.U.O.GJ “Koço Gliozheni”

Fondi limit/ Vlera e pritshme e kontratave është 19,206,400 (nentembedhjetë milion e dyqind e gjashtë mijë e katërqind ) lekë pa TVSH

Shumatorja e cmimeve për njësi për Lot 1 është 107,449.70 (njqind e shtate mije e katerqind e katerdhjetë e nente pike shtatedhjetë).

Loti 2 : “ Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja te S.U.O.GJ “Koço Gliozheni”

Fondi limit/ Vlera e pritshme e kontratave është 18,267,530 (tetembedhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH

Shumatorja e cmimeve për njësi është për Lot 2 është 45051.78 (dyzet e pese mije e pesedhjetë e nje pike shtatedhjetë e tete) leke

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor SUOGJ “Koço Gliozheni”, ka hartuar proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **II. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **PËR TË DY LOTET :**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a) *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në mbështetje të nenin 76 të Ligjit nr.162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”,në të cilën është e përcaktuar se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.*

b) *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se:

*Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

*a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.*

I. Loti 1 “Blerje materiale mjekimi për SUOGJ “Koco Gliozheni” , për një periudhë 12 mujore”

## 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, me objekt aktiviteti të certifikatës në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

- a. Operatori ekonomik ofertues në rastet kur nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet të paraqesë autodeklaratë që furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi është i certifikuar konform standarteve të cilësisë ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, të vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

AK rezervon te drejten për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit te dokumentacionit dhe në rastin kur OE ofertues shpallet fitues, duhet të paraqesë certifikatën në fjalë.

- b. Kërkohet Autodeklaratë për materialet mjekësore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat MDD 93/42/EEC /ose ekuivalent/ (sipas aplikimit të vlefshmërisë), bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti), sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, ose certifikim FDA. Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit.

**Argumentimi:** Këto kritere janë të në pikën b) dhe c) dhe është vendosur në përputhje me pikën 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: *1. Autoriteti ose enti kontraktuar për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuar nga një organ i*

*vlerësimin të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimin të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, datë 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

### **3. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

3.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare , ku vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e madhe se 40% e vlerës fondit limit/vlera e pritshme të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 3 viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës/ të lotit apo shumës së loteve për të cilat oferton. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

#### **1. Per secilin lot**

*Shënim\*: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit për të cilin ofertohe, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10 /ose/ 2.14*

*Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, vlera mesatare do te aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.*

*Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 te nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020,“Për Prokurimin Publik”, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...], ne piken 1 dhe piken 2/b te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se:Pika 1:Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/b: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.*

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Legjislatori në piken 1 dhe piken 2/b te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku percaktohet; Pika2/b: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftesinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.*

Referuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure AK ka menduar se vendosja e një vlerë minimale të xhiros jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit për të cilat konkurron operatori, është një dëshmi e mjaftueshme për të krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operatorët Ekonomike ofertues zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur/realizuar kontratën siç është parashikuar nga AK.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

---

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;\_si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;*

*(Shënim:citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë sa 20% të vlerës së fondit të limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

## **2.4 Per secilin lot**

*Shënim\*: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit për të cilën ofertohet, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” në piken 2.10 / 2.14*

*Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, 20% do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, në të cilin gjejmë të percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilin është e percaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë sa 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjestim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 4 të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjestim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga firma prodhuese ose distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi, për tregtimin e materialeve mjekësore objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kërkuar dhe origjinal ose fotokopje të noterizuara. **Per secilin lot**

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur mbështetur në pikat 2 dhe 4 të nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 5 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku është e cituar: 5. *Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit kërkohet të paraqitet, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues.

2. Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron, të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngarkohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. **Per secilin lot**

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur nga anëtari i NJP që ka specialitet përkatës në lidhje me kriteret teknike si dhe në përputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik, si dhe me pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se:[...] 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].*

Paraqitja e katalogëve për artikujt objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e përpuethshmërisë së mallit që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST në Shtojcën 5.

3. Operatori Ekonomik ofertues, duhet të paraqesë Autodeklaratë për afatin e skadencës së mallit sipas përcaktimeve në specifikimet teknike të Shtojcës 5. **Per secilin lot**

**Argumentimi:** Kriteri është vendosur në përputhje me nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, si dhe nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Deklarata mbi për afatin e skadencës është kërkuar në mënyrë që me anë të saj të krijohet garancia në cilësinë e mallit dhe që t’i përmbahet plotësimi të këtij kriteri gjatë gjithë ekzekutimit të minikontratave.

4. Deklaratë e ofertuesit mbi origjinën e mallit, vendi i prodhimit dhe kompaninë prodhuese. **Per secilin lot**

**Argumentimi:** Kriteri është vendosur në përputhje me nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, si dhe nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, pasi deklarata mbi origjinën e mallit (kompaninë prodhuese dhe vendi prodhimit) është kërkuar në mënyrë që me anë të saj të bëhet krahasimi i ofertës, materialeve që ofertohen nga OE me autorizimin e prodhuesit dhe dokumentacionin teknik që do të paraqitet në SPE.

5. Ofertuesi duhet të paraqesë Çertifikate konformiteti CE sipas direktivës MDD 93/42 EEC, (të përditësuar) ose MDR, për të gjithë artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre, të përkthyer dhe të noterizuar ose certifikate FDA, të perkthyer dhe të noterizuar. **Per secilin lot**

**Argumenti:** Ky kriter vendoset duke u bazuar në nenin 77, pika 4 e Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik”, te nenit 40, pika 5, germa a), nenin 44, te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

**Argumentimi:** *Specifikimet teknike janë hartuar në varësi të objektit të kontratës përcjellë me nga Grupi i punës ngritur me **Urdhër Prokurimit nr 46/2 datë 11.01.2024***

*Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përlllogaritur sasi të nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standartet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*



- c. Loti 2 “Blerje materiale mjekimi për SUOGJ “Koco Gliozheni” , për një periudhë 12 mujore”

## 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### 2.5 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- d. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, me objekt aktiviteti të çertifikatës në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.
- e. Operatori ekonomik ofertues në rastet kur nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet të paraqesë autodeklaratë që furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi është i çertifikuar konform standarteve të cilësisë ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, të vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

AK rezervon te drejten për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit te dokumentacionit dhe në rastin kur OE ofertues shpallet fitues, duhet të paraqesë çertifikatën në fjalë.

- f. Kërkohet Autodeklaratë për materialet mjekësore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat MDD 93/42/EEC /ose ekuivalent/ (sipas aplikimit të vlefshmërisë), bashkëlidhur me kopjet e çertifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti), sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, ose çertifikim FDA. Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit.

**Argumentimi:** Këto kritere janë të në pikën b) dhe c) dhe është vendosur në përputhje me pikën 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: *1. Autoriteti ose enti kontraktuar për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë*

*akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, datë 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

## **2.6 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2019, 2020 dhe 2021) ku vlera e tyre të jetë jo më e madhe se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit, për të cilën konkuron operatori ekonomik.

*Shënim\*: Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit për të cilën ofertohe, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10 /ose/ 2.14*

*Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, vlera mesatare do te aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.*

*Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 te nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...], ne piken 1 dhe piken 2/b te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se:Pika 1:Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/b: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.*

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Legjislatori në piken 1 dhe piken 2/b te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që

mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku përcaktohet; Pika2/b: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK. Referuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure AK ka menduar se vendosja e një vlerë minimale të xhiros jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit për të cilat konkurron operatori, është një dëshmi e mjaftueshme për të krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operatorët Ekonomike ofertues zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur/realizuar kontratën siç është parashikuar nga AK.*

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

---

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;\_si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;*

*(Shënim:citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore)*

## **2.2 Kapaciteti teknik:**

5. Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit të lotit për të cilën konkurron operatori dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes ku të evidentohen artikujt.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

*Shënim\*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit për të cilën ofertohet, konkretisht mbi vlerat e kolonës "Vlera e pritshme e kontratave" në pikën 2.10 / 2.14*

*Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, 20% do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", ne te cilin gjejme te percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilen eshte e percaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjestim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

#### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjestim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

6. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga firma prodhuese ose distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi, për tregtimin e materialeve mjekësore objekt prokurimi.

Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kërkuar dhe origjinal ose fotokopje të noterizuara.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur mbështetur në pikat 2 dhe 4 te nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 te nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku është e cituar: *5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë në përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit kërkohet të paraqitet, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues.

7. Për artikullin e ofruar të paraqiten Katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikullin (*pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen*). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron, të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do të ngakohen në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur nga anëtari i NJP që ka specialitet përkatës në lidhje me kriteret teknike si dhe në përputhje me nenin 4 pika 38, nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik, si dhe me pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: [...] *6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: [...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].*

Paraqitja e katalogëve për artikujt objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e përpuethshmërisë së mallit që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST në Shtojcën 5.

8. Operatori Ekonomik ofertues, duhet të paraqesë Autodeklaratë për afatin e skadencës së mallit sipas përcaktimeve në specifikimet teknike të Shtojcës 5.

**Argumentimi:** Kriteri është vendosur në përputhje me nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, si dhe nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Deklarata mbi për afatin e skadencës është kërkuar në mënyrë që me anë të saj të krijohet garancia ne cilësinë e mallit dhe që t’i përmbahet plotësisht të këtij kriteri gjatë gjithë ekzekutimit të minikontratave.

9. Deklaratë e ofertuesit mbi origjinën e mallit, vendi i prodhimit dhe kompaninë prodhuese.

**Argumentimi:** Kriteri është vendosur në përputhje me nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, si dhe nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, pasi deklarata mbi origjinën e mallit (kompaninë prodhuese dhe vendi prodhimit) është kërkuar në mënyrë që me anë të saj të bëhet krahasimi i ofertës, materialeve që ofertohen nga OE me autorizimin e prodhuesit dhe dokumentacionin teknik që do të paraqitet në SPE.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

**Argumentimi:** *Specifikimet teknike janë hartuar në varësi të objektit të kontratës përcjellë me nga Grupi i punës ngritur me **Urdhër Prokurimit nr 46/2 datë 11.01.2024***

*Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përlllogaritur sasi të e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standartet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

### **NJESIA E PROKURIMIT:**

- |                         |                       |
|-------------------------|-----------------------|
| <b>1. Blerim Stafa</b>  | <b>Shef/Farmacive</b> |
| <b>2. Erlisa Goziçi</b> | <b>Juriste</b>        |
| <b>3. Joana Dauti</b>   | <b>Ekonomiste</b>     |